



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13.02.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Gani Luta Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Kompaninë Rajonale për Mbeturina "Ambienti" SH.A në Komunën e Pejës.
CC:	z. Nexhat Abdullahu Krye shef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale për Mbeturina "Ambienti" SH.A në Komunën e Pejës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me thasë prej (najloni) për mbeturina të amvisërisë".



I nderuari z. Luta

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me thasë prej (najloni) për mbeturina të amvisërisë". numri prokurimit 12-002-121 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Kompania Rajonale për Mbeturina "Ambienti" SH.A në Komunën e Pejës t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetimin, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit për prokurimin publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

AK para se të fillojë ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit konform nenit 9 të LPP-se 03/L-241 dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një Deklaratë të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmerinë e Fondeve.

Nëse tenderi në fjalë është përfshirë në Planifikimin e Prokurimit atëherë dokumenti duhet të ruhet në dosje të tenderit. Nëse ky tender nuk është përfshirë në planifikim

të prokurimit, atëherë ZKA i AK duhet të përgatisë dhe ta dorëzoj Deklaratën në Agjensionin Qendror të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve para se Zyrtari Autorizues i Autoritetit Kontraktues të autorizoj Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit të prokurimit me çka sipas AKK-së, AK ka dështuar se respektuari dispozitën e mësipërme të nenit 9.

Zyra e prokurimit në Kompaninë Rajonale për Mbeturina "Ambienti" SH.A në Komunën e Pejës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit AMB-12-002-121 me titull "Furnizimi me thasë PVC të (Najllonit) për mbeturina të amvisërisë" në Pejë, në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 9.1 i Dosjes së tenderit të Kërkesat e përshtatshme profesionale pika 2 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar, veç tjerash, Mostra e Thesit PVC të (najllonit) të afuara.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të aneksi 6 t pika 2 tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë: "Vlerësimi i mostrës" pesha e këtij nën kriteri është 30 % të poenimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042 dh

Me respekt!